

Njoftim për konsultim publik

Bashkia Rrogozhinë, data 18.07.2024, ora 10.00, salla e Këshillit Bashkiak.

Titulli: Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, bashkia Rrogozhinë

Propozuesi: Projektakti është propozuar nga Kryetari i Bashkisë, z. Edison Memolla.

Sqarime për projektaktin: Relacioni sqarues i projektaktit përcakton arsyet e paraqitura nga propozuesi, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 5 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit:

- i. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2024 – 2029.
- ii. Zgjerimi i shërbimit në 100% në zonën urbane dhe 90% në zonën rurale gjatë periudhës 2024 – 2029
- iii. Rritja e shkallës së grumbullimit të diferencuar deri në masën 20% dhe pilotimi i sistemit të grumbullimit të diferencuar me dy kosha (të riciklueshme dhe të thata) për banorët në tre qendrat e tre njësjive administrative të Bashkisë (NJA Rrogozhinë Qendër, NJA Gosë Qendër, NJA Lekaj Qendër) 2024-2029.
- iv. Rritja e shkallës së grumbullimit të tarifës në masën 100% për bizneset, 90% për banorët dhe 100% për institucionet përgjatë periudhës 2024-2029.
- v. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2024-2029.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet në Qytetin e Rrogozhinës, në datën **18.07.2024, ora 10.00 salla e Këshillit Bashkiak.**

Grupet e interesit do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e vendosur në faqen web të bashkisë.

Pjesëmarrës:

Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve, Drejtorisë së Financës, Drejtori i Drejtorisë së Taksave, Kryetarë Këshilli, Kryetari i Komisionit të Shërbimeve në këshillin bashkiak Rrogozhinë, këshilltarë, Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit Publik, përfaqësues të administratës të Bashkisë Rrogozhinë.

- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit të Rrogozhinës dhe Njësjive Administrative të bashkisë, grupe biznesi si dhe organizata jo fitimprurëse, grupe të marginalizuara, etj.
- **Forma e konsultimit:** Takim publike

	1. Prezantimi me Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, bashkia Rrogozhinë.
--	--

Qëllimi i këshillimit publik	2. Evidentimi i çështjeve për diskutim të lidhura me prezantimet e objektivave strategjike e specifike, treguesve matës dhe masave të parashikuara në Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.
Përshkrimi i çështjeve trajton Vendor menaxhimit mbetjeve ngurta. Plani i	<p>Hyrja në fuqi e reformës territoriale u shoqërua edhe me një riorganizim të shërbimeve publike, ku njëri prej tyre është edhe ai i menaxhimit të mbetjeve. Kjo ndarje ofron mundësi të mira për përdorimin eficient të burimeve ekzistuese (makina për transportin e mbetjeve, kontenierë, vend-depozitime) ashtu dhe të burimeve njerëzore për këtë qëllim.</p> <p>Propozimi i skenarëve për organizimin e shërbimit në Bashkinë Rrogozhinë, do të bëhet bazuar në objektivin kryesorë të bashkisë për të ndërmarrë hapat për arritjen e standardit minimal të formimit të shërbimit. Të dy skenarët do të synojnë, në nivele të caktuara, ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshme nga taksa paguesit, për të synuar mbulimin e plotë të koston së shërbimit, bashkia propozon dy skenarë të mundshëm për ofrimin e shërbimit. Qëllimi i bashkisë është të rrisë cilësinë e shërbimit në sajë të përmirësimit të infrastrukturës dhe diversifikimin e shërbimeve që ajo ofron. Për secilin nga skenarët është bërë llogaritja e koston sipas modelit të miratuar me <i>VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"</i>. Formulimi i skenarëve është realizuar bazuar në konsideratat më poshtë:</p> <p>Skenari bazë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grumbullim i mbetjeve miks në 90% të zonës urbane dhe 70% zonës rurale 2. Transportim i tyre me mjete teknologjike. 3. Depozitimi i tyre në Impiantin me Trajtim Energjie në Elbasan në distancë 35 km një rrugë. <p>Skenari I</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane – NJA Rrogozhinë 100% dhe 90% zona rurale – NJA Kryevidh, NJA Gosë, NJA Lekaj, NJA Sinaballaj). 2. Transportimi me mjete teknologjike dhe ndërtimi i qendrave të transferimit (qendra për rikuperimin e materialeve). 3. Depozitimi 0% të sasisë së mbetjeve në venddepozitime të kontrolluara dhe 100% në TS drejt impianteve – Në rastin e Bashkisë Rrogozhinë transporti i mbetjeve do të bëhet në Impiantin me Trajtim Energjie në Elbasan deri në momentin e ndërtimit dhe bërjes aktive Stacionit të Transferimi në NJA Përparim në Bashkinë Peqin që do t'i shërbejë të dyja bashkive. Sipas studimit të fizibilitetit për Zonën e Mbetjeve Elbasan është përcaktuar që për dy bashkitë Peqin dhe Rrogozhinë si pjesë e Zonës së Mbetjeve Elbasan, është përcaktuar një Stacion transferimi në NJA Përparim në Bashkinë Peqin në venddepozitimin e Bashkisë Peqin Poligoni. Ky venddepozitim duhet të kalojë procesin e rehabilitimit dhe mbylljes për t'u kthyer në një Stacion Transferimi. Distanca për në Stacionin e Transferimit në NJA Përparim është 10 km një rrugë. 4. Identifikimi dhe eliminimi i grumbullimeve ilegale në të gjithë teritorrin e Bashkisë.

	<p>Skenari II</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane – NJA Rrogozhinë 100% dhe 90% zona rurale – NJA Kryevindh, NJA Gosë, NJA Lekaj, NJA Sinaballaj). 2. rumbullimi i diferencuar me 2 kosha / grumbullim i diferencuar për bizneset. Bashkia Parashikon që të fillojë ndarjen në burim të mbetjeve në qendrat e tre njësive administrative të Bashkisë (NJA Rrogozhinë Qendër, NJA Gosë Qendër, NJA Lekaj Qendër). Numri i popullsisë që do të bëhet pjesë e kësaj skemë në të tre qendrat e njësive administrative do të jetë 5,000 banorë dhe rreth 60% e bizneseve që gjenerojnë mbetje urbane do të jenë pjesë e kësaj skeme të ndarjes në burim me dy kosha 1.1 m³ (të njoma dhe të thata). 3. Transportimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve mix (në TS dhe qendra për rikuperimin e materialeve). – në NJA Përparim në Bashkinë Peqin në distancë 10 km në një rrugë. 4. Depozitimi të gjitha mbetjeve në impiante të përpunimit dhe asgjësimit përfundimtar - në Impiantin me Trajtim Energjie në Elbasan. 5. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave të tjera. <p>Bashkia Rrogozhine do te ndjeke skenarin II .</p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si e ofron shërbimin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve sot bashkia e Rrogozhinës? 2. Mendoni ju se duhet përmirësuar ky shërbim nga ana e Bashkisë dhe si? 3. Si e shikoni mundësinë për të pasur më në fund një Plan të menaxhimit të integruar të mbetjeve? Mendoni se situata do të përmirësohet? 4. Për cilin nga objektivat e Planit jeni skeptikë dhe pse? Si mund të përmirësohet Plani që të jetë më cilësor shërbimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve? 5. Tjetër
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Sherbimeve dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të sherbimeve të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor;

	<ol style="list-style-type: none"> 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen ëeb të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	<p>Sugjerimet janë të mirëpritura në adresat e emaileve:</p> <p>visi.shera85@gmail.com</p>
Data e publikimit	27.06.2024